



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:109307
Datë: 30.12.2024
Numri i dokumentit: 06666842

PAKR.nr.129/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afërdita Bytyçi – kryetare e kolegjit, Vaton Durguti dhe Skender Çoçaj – anëtar të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve Rr.M., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, M.A., A.M dhe Rr.M. për shkak të veprës penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme, në bashkëkryerje, nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-ës, dhe M.A dhe A.M. për shkak të veprës penale Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK-ës, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.8K/2019 e dt.22.01.2024, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.132/2019 të datës 22.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-se, me datë 20.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e pjesshëm të ankesës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.8K/2019 e dt.22.01.2024, e sipas detyrës zyrtare, **ANULOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.132/2019 të datës 22.12.2023, në pikë II dhe III të dispozitivit dhe në këtë pjesë çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykimi.

II.Në pjesën tjetër ankesa e Prokurorisë në raport me pikën I të dispozitivit për të akuzuarën, Rr.M., për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.132/2019 i datës 22.12.2023 për këtë pikë (I) **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.132/2019, të datës 22.12.2023, konform nenit 363 par.1nëpar.1.3 të KPK-së, të akuzuarën Rr.M., si në pikën I të dispozitivit e ka liruar nga akuza penale për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit M.A., A.M. dhe Rr.M., si në pikë II të dispozitivit i ka liruar nga akuzua për veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së rremë në bashkryerje, nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, si dhe të akuzuarit M.A. dhe A.M., si në pikën III të dispozitivit i ka liruar nga akuzua për veprën penale Mashtrim në bashkëryerje nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 dhe lidhur, për shkak se nuk është provuar se të akuzuari kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale kanë rënë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Pala e dëmtuar Dogana e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj apo çështjen t’a kthej në rivendosje.

Përgjigjen në ankesën e Prokurorisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarës Rr.M. av. R.G., me propozim që të refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krimet të Rënda të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.135/2024 të datës 05.03.2024 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa të refuzohet si e pabazuar përgjigjja në ankesë të PTH-së në Mitrovicë, e ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarës Rr.M. - av.R.G.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së, në të cilën ka prezantuar e akuzuara Rr.M. me mbrojtësin av.R.G., i akuzuari M.A. me mbrojtësin av.B.Sh., ndërsa nuk prezantuan askush nga Prokuroria e Apelit, e dëmtuara Dogana e Kosovës, i akuzuari A.M. dhe av.R.M., edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, e në të cilën seancë mbrojtësi i të akuzuarës Rr.M. - av.R.G. mbeti pranë përgjigjes në ankesë dhe propozim si në këtë përgjigje të ankesës.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit gjyqësor dhe shqyrtoj shkresat e lëndës, gjithashtu vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se ankesa është pjesërisht e bazuar.

Pretendimet ankimore

Në ankesë Prokuroria Themelore në Prishtinë pretendon se Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues me të cilin i ka liruar nga aktakuza të akuzuarit nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, ngase Prokuroria i ka prezantuar prova të mjaftueshme Gjykatës së shkallës së parë të cilat po ti vlerësonte drejtë Gjykata do të vërtetohej se të akuzuarit e lartcekur kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar si në aktakuzë. Prokuroria më tej shton se Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues. Tutje konsideron se ky aktgjykim është jo i drejtë dhe i pabazuar dhe nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare. Po ashtu thekson se Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë provat të cilat Prokuroria i ka propozuar në aktakuzë të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor e me të cilat prova vërtetohet gjendja faktike ashtu siç është cekur në aktakuzë, se në veprimet e të akuzuarës Rr.M. manifestohen elementet e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, se në veprimet e të akuzuarve Rr.M., M.A. dhe A.M. manifestohen elementet e veprës penale Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 403 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, se në veprimet e të akuzuarve M.A. dhe A.M. manifestohen elementet e veprës penale në

bashkëkryerje Mashtrimi nga neni 335 par.5 lidhur me par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe se qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale për të cilat akuzohen. Sipas Prokurorisë, ky aktgjykim lirues është jo i drejtë, i pabazuar, dhe me të njëjtin aktgjykim Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e ligjit penal kur të akuzuarit e lartcekur i ka liruar nga aktakuza për veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarës Rr.M. av. R.G., i cili konsideron se pretendimet si në ankesë janë në tërësi të pabazuara ngase gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur ka nxjerr aktgjykim lirues sepse nuk është vërtetuar se e mbrojtura e tij të ketë kryer veprat penale që i vihen në barrë, duke propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit pas analizimit të aktgjykimit të ankimuar dhe shkresave të lëndës e duke vlerësuar pretendimet ankimore të Prokurorisë, gjen se përkitazi me pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar e në raport me të akuzuarën Rr.M., për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetet zyrtarë nga neni 422 par.1 të KPK-së, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, të cilat sipas detyrës zyrtare i shqyrton edhe kjo Gjykatë, pasi që për këtë pikë dispozitivi është i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, në të cilin arsyetim gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet të qarta dhe konkrete nga të cilat ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale për të akuzuarën Rr.M për pikën I të dispozitivit, nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, nuk është vërtetuar se e njëjta të ketë kryer këtë veprë penale, për të cilën konkludim pajohet dhe kolegji penal i kësaj gjykate si përfundim të drejtë dhe ligjor.

Gjykata e shkallës së parë, përkitazi me pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar e në raport me të akuzuarën Rr.M., konform dispozitës së nenit 360 të KPP-së, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto provat ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë në këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji penal i kësaj gjykate, duke vlerësuar pretendimet ankimore të Prokurorisë për vërtetim jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike përkitazi me pikën I të aktgjykimit të ankimuar e në

raport me të akuzuarën, Rr.M., për veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par.1 të KPP-së, gjen se ky pretendim është i pabazuar ngase gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësorë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë faktet relevante në këtë çështje penale dhe rrjedhimisht nuk ka mbetur asgjë në nivel *dubioz apo dykuptimsh përkitazi me këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar*.

Kolegji penalë i kësaj gjykate gjen se ankesa e prokurorisë në raport me bazën ankimore të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penalë, në raport me pikën I të dispozitivit është e pabazuar, pasi që në këtë pikë gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka vërtetuar në mënyrë të drejtë se, nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, nuk është provuar se e akuzuara Rr.M. të ketë kryer veprën penale si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, për të cilën veprë penale prokuroria e ka ngarkuar me aktakuzën e saj.

Gjykata e Apelit gjen si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, ku të akuzuarën, Rr.M., me aktgjykimin e ankimuar, konform nenit 363 par.1 nëpar.1.3 të KPP-së e ka liruar nga akuzua për veprën penale, si në pikën I të dispozitivit, Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPP-së. Kjo pasi që në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet të qarta dhe konkrete nga të cilat ka ardhur në përfundim për ta liruar nga akuza për këtë veprë penale, si në pikën I, të akuzuarën Rr.M., meqenëse nga provat e administruara është vërtetuar se e akuzuara në këtë rast nuk ka vepruar në kundërshtim me autorizimet e saj ligjore si pretendon prokuroria në aktakuzë **“se e akuzuara ka vepruar në kundërshtim me autorizimet e saj duke mos respektuar procedurën përmbareme e duke mos bërë krahasimin e dokumenteve të paraqitura nga i pandehuri M.A.”**, por e akuzuara si përmbareme private kishte vepruar konform dispozitave të ligjit 04/L-139 për procedurën përmbareme (LPP), dhe atë konform nenit 29 par.1 nën par. 1.3, ku si dokument i besueshëm ligji njih edhe **faturat**, gjë që në bazë të kësaj-fature (101/2016 të dt.15.01.2015) e akuzuara kishte caktuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm (siç vërtetohet edhe nga propozimi për përmbaremin **“provë; Fatura nr.101/2016 dt.15.01.2016**) dhe që sipas nenit 37 të LPP-së e cila dispozitivë parasheh decidivisht se **“kur propozimi për përmbaremin paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm mjafton që propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e vërtetuar”** andaj, konform nenit 21 të LPP-së, i cili parasheh se **“Organi përmbaremes e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaremin vetëm në bazë të dokumentit përmbaremes (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”**, rezulton qartazi se veprimet e të akuzuarës Rr.M. nuk ishin në kundërshtim me

autorizimet e saj ligjore, si pretendon prokuroria, (*edhe pse prokuroria në përshkrim faktik nuk ka saktësuar se në kundërshtim me cilën dispozitë të LPP kishte vepruar e akuzuara në këtë rast*) por të gjitha veprimet e saj ishin në kuadër të kompetencave ligjore dhe konform dispozitave të LPP-së, si kishte dëshmuar edhe dëshmitari, A.G., në këtë çështje penale për procedurën përbarimore me theks se edhe gjatë kohës kur çështja është duke u trajtuar me padi, mund të fillohet dhe vazhdohet procedura e përbarimit pasi që padit në procedurën civile nuk e ndalojnë procedurën e përbarimit, përveç në rastet kur gjykata ka nxjerrë ndonjë vendim specifik për masë të përkohshme lidhur me lëndën konkrete dhe që përbaruesi nuk ka detyrim dhe as nuk është kompetent për të kryer çfarëdo lloj hetimi pasi që LPP-ja në asnjë dispozitë nuk i ka dhënë këtë kompetencë për të kryer hetimet e tilla.

Si me të drejtë kishte konstatuar gjykata e shkallës së parë, e akuzuara në këtë rast kishte vepruar konform dispozitave të Ligjit për procedurën e përbarimit, pasi që me inicimit-caktimit të përbarimit- sipas procedurës të paraparë përbarimore, në urdhërin e nxjerrë për përbarim kishte udhëzuar palët në të drejtën për mjetin juridik-prapësimin, gjë e cila edhe ka ndodhur në këtë rast, ku nga dëshmia e dëshmitarit, Sh.H., është vërtetuar se ai, në pozitën e avokatit shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë, ndaj propozimit në fjalë ka ushtruar prapësim, qasi që e ka kuptuar se borxhi për të cilin bëhej fjalë është në gjykatë sipas padisë e cila nuk kishte përfunduar akoma, duke propozuar që propozimi për përbarim të shndërrohet në padi, pasi që ka vërejtur se petitumi ka mospajtim dhe ka sugjeruar që rasti të zgjidhet me padi në procedurë kontestimore, duke shtuar se jo vetëm në këtë rast, por edhe në rastet tjera se faturat si dokument i besueshëm kur vlera e faturës ka qenë 500 euro ai ka ushtruar kundërshtim, me përjashtim të rasteve kur kanë marrë mendim me shkrim nga debitori që të mos ushtrojnë kundërshtim.

Në anën tjetër, nga provat e administruara në këtë çështje penale, respektivisht dëshmitë e dëshmitarëve në këtë çështje penale, nuk ka rezultuar asgjë inkriminuese në drejtim të veprimeve e të akuzarës për veprën penale për të cilën është akuzuar, të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 të KPP-së, pra nëse e pandehura në këtë rast të caktimit të përbarimit kishte tejkuluar kompetencat ose nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare *me qëllim* të përfitimit të çfarëdo dobie për vetën apo tjetrin apo që ti shkaktoj dëm personit tjetër ose t'i shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër si pretendon prokuroria, por nga provat e kësaj çështje penale rrjedh se në këtë rast e akuzuara Rr.M. kishte ndjekur dhe ndërmarrë veprimet në kuadër të kompetencave ligjore dhe konform dispozitave të procedurë përbarimore duke lëshuar urdhër për caktimin e propozimit të propozuar sipas dokumentit të besueshëm-faturës, e që në fakt në bazë të dispozitave ligjore të ligjit për përbarim gjykatat e rregullta, sipas mjeteve juridike të

ushtruara nga palët në procedurë, paraqiten si hallkë për vlerësimin e rregullësisë dhe ligjshmërisë për urdhrin e caktuar nga përmbartuesit privat, gjë si edhe ka ndodhur në këtë rast gjegjësisht kishte vepruar e akuzuara të përshkurar si më lartë, prandaj nga kjo gjendje faktike e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë rrjedh se as ligji penal të mos jetë shkelur në favor të pandehurës, si pretendon prokuroria në ankesë, ngase nga provat e administruara nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës Rr.M., për pikën I të dispozitivit konsumohen elementet e veprës penale e rrjedhimisht nuk ka as aplikim të ligjit penal në raport me pikën (I) të aktgjyqimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, pas analizimit të aktgjyqimit të ankimuar dhe shkresave të lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore të prokurorisë për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, të cilat sipas detyrës zyrtare i shqyrton edhe kjo Gjykatë, në raport me pikën II dhe III të dispozitivit për të akuzuarit M.A., A.M. dhe Rr.M., për shkak të veprës penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme, në bashkëkryerje, nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK-ës, dhe M.A. dhe A.M. për shkak të veprës penale Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 335 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPK-ës, gjeti se aktgjyqimi i ankimuar në këtë pjesë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 1 dhe 2 nënpar.2.7 që ndërlidhen me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPP-së, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjyqimin e ankimuar nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjyqimit konform par.6 më konkretisht për pikën II nuk ka asnjë arsyetim dhe rrjedhimisht sipas para.7 të nenit 369 të KPP-së, nuk ka dhënë arsyet të qarta dhe në mënyrë të plotë se cilat faktet dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për vlerësimin edhe saktësinë e provave kundërthënëse, e që si rrjedhojë e këtyre shkeljeve esenciale edhe gjendjen faktike të mos ketë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për faktet vendimtare në këtë çështje penale, në raport për këto pika të dispozitivit të aktgjyqimit, e që në këtë drejtim dispozitivi i aktgjyqimit të mos jetë në përputhje me arsyetimin e tij.

Nga shiqimi i arsyetimit të aktgjyqimit të ankimuar, fq.33, në raport me këto pikat të dispozitivit të aktgjyqimit, gjykata e shkallës së parë përveç përshkrimit inkriminues për pikën II, veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme, në bashkryerje, nga neni 403 par.1 lidhur me nenin 31, për të cilat i ngarkon akuzua të pandehurit në fjalë, gjykata e shkallës së parë në arsyetim vetëm konstaton se nga ky përshkrim përmbushen elementet e veprës penale të mashtrimit në bashkëkryerje të paraqitur në pikën 3 të dispozitivit të akuzës pra nuk ka fare arsyetim gjë që për këtë pjesë aktgjyqimi është përfshirë në shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.10 të KPP-së, ndërsa për veprën penale të mashtrimit në

bashkëkryerje, arsyeton se; nga i akuzuari A., i cili i kishte njoftuar inspektorët dhe policinë se derivatet e naftës gjendeshin në fshatin Livagjë por ata nuk kishin pranuar të shkonin atje për ta vërtetuar atë gjendje dhe *për të parë nëse pretendimet e të akuzuarit A. ishte i vërtetë apo i njëjti kishte për qëllim që ti mashtronte*, rezulton qartë se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban një arsyetim të qartë dhe konkretë se nga cilat provat gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim si në dispozitiv të aktgjykimit, por nga arsyetimi i tillë rrjedh se për fakteve relevante në këtë çështje penale gjendja faktike ka ngelur në nivel supozues e të pa vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për *qëllimin e të pandehurit si vërteton gjykata e shkallës së parë*, në drejtim të veprës penale të mashtrimit-objekt i akuzues për pikën III e të cilën pikë e ndërlihdh me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, andaj nga këto arsye kjo Gjykatë gjen se aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, e të cilat shkelje kushtëzojnë anulimin e këtij aktgjykimi dhe kthimin e çështjes në rigjykim në gjykatë të shkallës së parë.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë në raport me pikën II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk ka dhënë arsye përkitazi me faktet relevante të kësaj çështje penale, në veçanti për të vlerësuar se në fakt kush ishte arsye e saktë se pse nuk ishte nafta por është gjetur uji në rezervuarët e kompanis R. Commerc, me rastin e verifikimit nga policia dhe inspektoriati i MIT-së, kjo pasi që nga deklarata e të pandehurit A.M., të dhënë në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor, fq.29, të aktgjykimit të ankimuar mes tjerash, ka thënë se *“me datë 22 ose 23 shkurt të vitit 2019, një kompani e quajtur “V.K.” e autorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – MTI, ka kërkuar që t’i mbushë rezervuarët me ujë me presion edhe për pastrimin e tyre pasi të testohen me ujë, e punëtorët e saj kanë pasur një dokument përkatësisht kërkesë të M.A. për testimin e rezervuarëve”*, ndërsa i pandehuri M.A. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor, ndër të tjera, fq.27, të aktgjykimit të ankimuar, ka deklaruar *“se gjatë kësaj periudhe kohore ai nuk i ka shitur derivatet e doganës, të cilat në kompaninë R. C. kanë qëndruar nga fillimi i vitit 2009 deri me 04.01.2019, ndërsa me datë 18.12.2018 pronari i R. C. ka kërkuar nga ai që t’i heqë derivatet nga rezervuarët e tij pasi hapësirat i duheshin për nevojat e kompanisë së tij dhe ai me datë 04.01.2019 i ka hequr derivatet dhe i ka dërguar në fshatin Livagjë, e që në fakt gjykata e shkallës së parë do të duhej dhënë arsye ligjore për këto kundërthënie nga të cilat kishte për të vërtetuar apo jo këtë fakt sidomos arsyen dhe qëllimin e mbushjes së këtyre rezervuarve me ujë në ditën kritike.*

Për më tepër, nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rezulton se gjykata edhe gjendjen e fakteve të ketë konstatuar në kundërshtim me provat e shkresave të lëndës, kjo pasi që nga arsyetimi,

fq.33, pasuesi II, gjykata e shkallës së parë konstaton se*dogana jo vetëm që nuk i ka tërhequr këto derivat brenda kohës për të cilën janë marrë vesh, por kjo ka zgjatur për një kohë të gjatë së cilës tani i akuzuari A. disa herë ka kërkuar nga dogana që ti tërheq këto derivate por dogana as atëherë e as deri më tani, nuk kanë tentuar në ndonjë formë qoftë me komunikim apo me verpime konkrete që të tërheq derivate e tyre nga rezervarët ku i ka mbajtur tani i akuzuari M.A.*

Mirëpo, në fashikull i shkresave të kësaj lënde penale, ekziston e bashkangjitur prova- kërkesa e Doganës së Kosovës, e evidentuar me vulë katrore, nr.373 02 të datës 16.10.2006, që i janë drejtuar, këtu të pandehurit M.A., me kërkesë për kthim të mallit-237,559 lt naftë (dizel D2), me paralajmërim se në të kundërtën do të jetë e detyruar të inicioj procedurë përkatës ligjore prandaj, një konstatim i tillë i gjykatës së shkallës së parë është jo i drejtë dhe i saktë pasi që është në kundërshtim me provat e shkresave të lëndës e që lidhen me të provuarit e fakteve relevante për të cilat ka konstatuar gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit vëren se meqenëse në këtë çështje penale thelbi pretendues i akuzës në ngarkim të akuzuarve për veprat penale, legalizimit i përmbajtjes së rremë dhe të mashtrimit për qëllimet e përfitimeve të kundërligjshme në procedurën civile që zhvillohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjykata e shkallës së parë, edhe pse në këtë çështje penale janë administruar disa provat materiale nga kjo lëndë, duhet që në rigjykim të marrë në shiqim nga Gjykata Themelore në Prishtinë-div.civil lëndën, C.nr.1998/07, për palët ndërgjyqëse- paditës; Dogana e Kosovës kundër të paditurit; M.A-pronar i kompanisë NTP “T.”, për kthimin e asaj sasive të naftës-objekt akuze, nga e cila në mes tjerash, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet se në momentin e marrjes së vendimit për angazhim të ekspertëve për vërtetim të cilësisë së naftës, ku ishte deklaruar se gjendet nafta e depozituar në ruajtje (në cilët rezervuar-compani) pasi që nga shkresat e kësaj lënde penale rrjedh se një vendim të tillë gjykata civile kishte marrë (*pak kohë para se të ndërhynte policia*) por që më pas kishte ndërhyrë policia dhe procedura civile ishte ndërprerë deri në zgjidhjen e kësaj çështje penale.

Po ashtu, në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të ftoj për ti dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve zyrtarë policor dhe inspektorin-at, me emër të cilët ishin prezent dhe operuar, e të konstatuar si në procesverbalet në vend ngjarje me rastin e inspektimit të rezervuarve në kompanin “R.C.” në fshatin Llapnasellë, me qëllim për ti dëgjuar për rrethanat e pretenduara nga i pandehuri M.A. “*se i kishte njoftuar inspektorët dhe policinë se derivatet e naftës gjendeshin në fshatin Livagjë por ata nuk kishin pranuar të shkonin atje për ta vërtetuar atë gjendje*”.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë në rigjykim duhet të urdhëroj inspektoriatin nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me trupa inspektuese përkatëse për dal vend, depon-rezervuar të pronarit D.S., për të vërtetuar nëse kjo sasi e naftës e marrë nga Dogana e Kosovës në ruajtje dhe depozitim nga i pandehuri M.A. gjendet e vendosur në ruajtje dhe depozitim në rezervuarët e pronarit-dëshmitarit D.S., dhe njëkohësisht nëpërmjet urdhërit për angazhim të ekspertit financiar të vërtetohet aktiviteti afarist në raport me kontratat të paraqitura në këtë çështje penale për marrjen me qira të rezervuar në shfrytëzim nga kompania “R.C.” dhe D.S., nga i pandehuri M.A. apo kompania e tij “T.” kjo pasi konform dispozitës së nenit 7 të kodit të procedurës penale detyron që; Gjkata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.

Gjkata e Apelit gjen se, meqenëse aktgjykimi i ankimuar për pikën II dhe III të dispozitivit është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për faktet e theksuara si më lartë e për të cilat është e nevojshme që gjykata e shkallës së parë, të përsëris shqyrtimin gjyqësor për të dëgjuar dëshmitarët e drejtpërdrejtë të ngjarjeve dhe marrjen e provave material, e të cekura si më lart, andaj nga arsyet e sipër cekura aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, pasi që në kuptim të nenit 403 të KPP-së, Gjkata e Apelit nga konstatime e bëra lidhur me këto shkelje të lartcekura nga gjykata e shkallës së parë, nuk mund të korrigjoj duke ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar pasi që duhet përsëritur shqyrtimi gjyqësor. Në rigjykim Gjkata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e lartcekura, t’i eliminoj të gjitha shkeljet e cekura, t’i administroj të gjitha provat, dhe të njëjtat t’i vlerësoj në pajtim me dispozitën e nenit 369 të KPP-së, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e mandej të merr vendim të drejtë dhe ligjor.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 dhe 402 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.129 /2024, datë 20.06.2024

Bashkëpunëtor Profesional,

Bajram Rexhahmetaj

Kryetare e kolegjit,

Afërdita Bytyçi

Vaton Durguti

Skender Çoçaj
